



Konferenca e Dytë Shkencore, 12-13 Dhjetor

INOVACIONI NË INSTITUCIONET SUPREME TË AUDITIMIT

M.Sc. Evis Çela
Audituese e lartë, KLSH
e-mail: ecela@klsh.org.al

ABSTRAKT

Shoqëria jonë po ndryshon me ritme të shpejta. Vitet e fundit kanë qenë dëshmitare të zhvillimit marramendës të teknologjisë së informacionit, internetit dhe metodave të punës gjithnjë e më tepër inovative. Këto zhvillime kanë sjellë ndikimin e tyre në politikën, qeverisjen, shoqërinë dhe demokracinë e shteteve.

Ashtu si çdo sektor tjetër në shoqëri apo ekonomi, sektori publik dhe institucionet supreme të auditimit si pjesë e tij, përballen me presionin e inovacionit dhe kryerjes së punëve në mënyrë të ndryshme e inovative, duke synuar arritjen e rezultateve më të mira si dhe përmbushjen e pritshmërive të qytetarëve dhe grupeve të tyre të interesit. Inovacioni është një proces i vështirë, por shumë i vlefshëm dhe efektiv për arritjen e rezultateve të synuara.

Nën dritën e këtyre zhvillimeve, në nismën e re të ndërmarrë nga EUROSAl për herë të parë në Nëntor të këtij viti, është organizuar Kongresi ``YOUNG EUROSAl``, fokusi i të cilit ishte pikërisht inovacioni.

Fjalët kyçe:

Inovacion, IT, efektivitet, ISSAI